

— RAPORT MONITORIMI —

**PËRDORIMI I BURIMEVE
SHTETËRORE NË ZGJEDHJET
E PJESSHME VENDORE 6
MARS 2022**

MARS 2022



 Funded by
UK Government

Ky raport është hartuar në kuadër të projektit “Monitorimi i përorimit të burimeve shtetërore në fushatë zgjedhore” zbatuar nga Qëndresa Qytetare dhe mbështetur nga Ambasada Britanike në Tiranë.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe nuk përfaqëson domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.

PËRMBAJTJA


1. KONTEKSTI
2. GJETJET KRYESORE
3. PËRDORIMI I BURIMEVE SHETETERORË NË FUSHATË
4. MONITORIMI I PREMTIMEVE TË KANDIDATËVE
5. DITA E ZGJEDHJEVE
6. REKOMANDIME

1.KONTEKSTI

Gjashtë bashki të vendit në 6 mars 2022 iu nënshtuan zgjedhjeve të pjesshme vendore të dekretuara më 20 janar 2022 nga Presidenti i Republikës, për të rizgjedhur Kryetarët e Bashkive, pozicione të lëna vakante për shkak të largimit të kryetarëve të zgjedhur në vitin 2019 për arsye të dekriminalizimit apo arsye shëndetësore.¹ Dekreti i munguar prej dy vjetësh për shkak të konflikteve mes Presidentit dhe mazhorancës në Gjykatën Kushtetuese, doli në një moment kur opozita ishte e ndarë në dy kampe.

Qytetarët e Bashkive Shkodër, Durrës, Lushnjë, Dibër, Vorë dhe Rogozhinë patën në dispozicion 18 kandidatë për të votuar në 6 mars të cilët vinin nga tre grupime politike si Partia Socialiste, Partia Demokratike e përfaqësuar nga Lulzim Basha dhe Koalicioni Shtëpia e Lirisë, e përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, i drejtuar de facto nga Sali Berisha, LSI dhe PDK.

Më 23 korrik 2020 hyrën në fuqi ndryshimet e reja në Kodin Zgjedhor, të dakordësuara në Këshillin Politik në 5 qershor të po këtij viti. Përveç ndryshimeve në aspektin e financimit të partive politike, listave gjysëm të hapura dhe përfshirjes së teknologjisë në zgjedhje, me kërkesë të opozitës u realizuan ndryshime edhe në aspektin e përdorimit të burimeve shtetërore në mbështetje të subjekteve zgjedhore dhe veprimtarive të institucioneve publike në



¹ <https://president.al/presidenti-meta-dekret-on-aktimin-e-dates-6-mars-2022-per-zhvillimin-e-zgjedhjeve-te-pjesshme-vendore-per-kryetar-bashkie-per-disa-njesi-te-qeverisjes-vendore/>



fushatë. Këto ndryshime synonin të kufizonin dhe ndalonin përdorimin e asetëve, burimeve njerëzore dhe punësimeve, 4 muaj nga dita e zgjedhjeve.² Pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, në 24 dhjetor 2020 Komisioni Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nxori vendimin nr.9 për Rregullat e Raportimit të Veprimtarive të Institucioneve Publike dhe Veprimtaritë e Ndaluar në Fushatë Zgjedhore.³

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, nën presionin e afateve ndërmori disa vendime që i lejonte data 6 mars, duke përgjysmuar kohën e një fushate zgjedhore normale nga 30 në vetëm 14 ditë dhe duke vendosur datën 31 janar si limit për raportimin e aktiviteteve me karakter publik të institucioneve shtetërore. Afatet e vendosura për depozitimin e kandidaturave ishin të disfavorshme për kandidatët e pavarur në zgjedhje, pasi pamundësonin ndjekjen e procedurave dhe mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për t'u regjistruar.

Partitë politike dhe kandidatët u dakordësuan për numrin e komisionerëve në QV dhe KZAZ sipas përcaktimeve ligjore, zhvilluan një fushatë pa programe të shkruara, pa debate mes kandidatëve dhe nën një klimë të tensionuar politike.

Dita e votimeve mbarti tërësisht problematikën e zgjedhjeve të 25 prillit, si prania e personave të paautorizuar dhe grumbullimeve pranë qendrave të votimit, votimin familjar, vështirësitë në qasjen digjitale gjatë procesit elektronik dhe klimën e tensionuar mes palëve politike.

² http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Kodi-Zgjedhor-2020_perditesuar_apz.pdf

³ http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendim_Nr.009_201224_Rregullat-e-raportimit-te-veprimtarive-me-karakter-publik-te-cdo-lloj-institucioni-publik-e-me-kapital-shteteror-agjencive-enteve-shteterore-kategorite-e-veprimtarive-te-ndaluara--2.pdf

2. GJETJET KRYESORE



Qëndresa Qytetare kallzoi 11 raste të përdorimit të burimeve shtetërore në fushatën zgjedhore pranë KQZ duke ngritur dyshime të arsyeshme se administrata dhe asetet publike u vendosën në dispozicion të fushatës duke krijuar pabarazi në garën elektorale.



Disa **Ministra u angazhuan sistematikisht në fushatë zgjedhore** duke u shfaqur rregullisht krahas kandidatëve për kryetar bashkie në vizita inspektimesh, takime elektorale apo inaugurime objektsh.



Bashkitë dhe institucionet qendrore gjatë periudhës zgjedhore intensifikuan shpërndarjen e fondeve të tërmetit, lancuan skema të përfitimit të granteve, dhe nxorën akte për shpërndarjen e ndihmave ndaj familjeve në nevojë duke ndikuar garën elektorale.



Dhjetra aktivitete të institucioneve shtetërore **nuk respektojnë afatin 5 ditor të raportimit pranë KQZ**. Gjithashtu një pjesë e njoftimeve të veprimtarive të raportuara nuk kishin informacion të detajuar duke i pamundësuar KQZ-së kalsifikimin e tyre si të lejuara apo të ndaluara.



Asnjë prej kandidatëve që garoi në zgjedhjet e 6 marsit **nuk pati program të shkruar dhe detajuar**. Kandidatët refuzuan përballjen dhe premtimet, kryesisht të kandidatëve që fituan garën e 6 marsit ishin të përgjithshme, pak të fokusuara në ndërhyrje për zona specifike dhe një pjesë prej tyre kopetencë e qeverisë qendrore.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përgjysmoi kohën e një fushate zgjedhore normale nga 30 në vetëm 14 ditë. Afatet e vendosura për depozitimin e kandidaturave ishin të **disfavorshme për kandidatët e pavarur në zgjedhje**, pasi pamundësonin ndjekjen e procedurave dhe mbledhjen e nënshkrimeve të nevojshme për t'u regjistruar.



Gjatë procesit të votimit u evidentuan serisht raste të votimit familjar, grumbullimiet pranë qendrave të votimit dhe ndikimi i votuesve nga persona të paautorizuar ose vëzhgues të partive.



Teknologjia në zgjedhje përmirësoi ndjeshëm procesin e numërimit por shfaq problematika teknike përgjatë votimit.

3. PËRDORIMI I BURIMEVE SHTETERORË NË FUSHATË



Qëndresa Qytetare monitoroi veprimtaritë publike dhe burimet e institucioneve shtetërore gjatë periudhës 31 janar – 5 Mars 2022. Fillimisht u krijua një mekanizëm raportimi në kohë reale i përbërë nga 6 sinjalizues të cilët adresuan në total 30 çështje, si shkelje të Kodit Zgjedhor në fushatë. Ekipi i juristëve pranë Qëndresës Qytetare filtoi adresimet

duke proceduar në kallzime administrative 11 nga 30 çështjet e mbërritura, për të cilat ishin siguruar prova dhe informacione filmike apo fotografike që përkonin me objektin e Vendimit nr.9 të Komisionit Rregullator pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.⁴

Referuar detyrimit për raportimin e veprimtarive publike institucionet qendrore dhe vendore shfaqën problematika në zbatimin e Kodit Zgjedhor. Gjatë monitorimit të ndëfaqës së raportimeve pranë KQZ Qëndresa Qytetare konstatoi se shumë aktivitete të realizuara nga institucionet nuk u raportuan në kohë duke mos respektuar afatin 5 ditor për raportim sipas nenit 4, pika të vendimit nr 9, të Komisionit Rregullator.

Tematika e Veprimtarisë së kryer nga institucionet raportuese ishin jo të plota dhe të përgjithshme. Mungesa e detajuar e informacionit mbi tematikën e veprimtarisë pamundësonte Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve klasifikimin e veprimtarisë si e lejuar apo si e ndaluar.⁵

Nga ana tjetër, praktika e angazhimit të ministrave në fushatë zgjedhore ishte e pranishme edhe në këto zgjedhje të pjesshme ku ata u shfaqën rregullisht në vizita inspektimesh apo inagurime objektsh. Disa prej tyre qëndruan të stacionuar për 14 ditë në bashkitë ku zhvilloheshin zgjedhje, duke luajtur edhe rolin e udhëheqësit të fushatës si në rastin e Dibrës dhe Shkodrës.⁶ Bashkitë dhe institucionet qendrore gjatë periudhës zgjedhore intensifikuan shpërndarjen e fondeve të të tërmetit, rasti i Bashkisë Durrës, lancuan skema të përfitimit të granteve, rasti i thirrjes së Bujaqësisë për fermerët dhe nxorrën akte për shpërndarjen e ndihamve ndaj familjeve në nevojë.

⁴ http://kqz.gov.al/wp-content/uploads/2020/12/Vendim_Nr.009_201224_Rregullat-e-raportimit-te-veprimtarive-me-karakter-publik-te-cdo-lloj-institucioni-publik-e-me-kapital-shteteror-agiencie-enteve-shteterore-kategorite-e-veprimtarive-te-ndaluar--2.pdf

⁵ <https://aktivitete.kqz.gov.al/>

⁶ <https://dosja.al/video-ja-si-ulsi-manja-mbledh-administraten-civile-per-fushaten/>

Këto lloj aktiviteteve i dhanë një avantazh të konsiderueshëm Partisë Socialiste e cila udhëheq qeverinë qendrore dhe qeveritë lokale në 61 bashki, duke prekur barazinë e palevë në garën elektorale.

Nisur nga praktika e ndjekur gjatë zgjedhjeve të 25 prillit, nevoja për rishikim të ligjit zgjedhor në këtë aspekt është imediate dhe duhet të jetë objekt i komisionit parlamentar të reformës zgjedhore për ti paraprirë një shfrytëzimi të mundshëm të burimeve shtetërore në zgjedhjet vendore të vitit 2023.

Bazuar në gjetjet e monitorimit dhe kallzimet e Qëndresës Qytetare, burimet shtetërore në fushatën e zgjedhjeve të pjesshme vendore të 6 marsit u përdorën në format e mëposhtme:

- **Premtim për rindërtim banese në prezencë të kandidatëve për Kryetarë Bashkie**



Premtim për rindërtimin e banesës së djegur në fshatin Obot nga Drejtori i Agjencisë së Emergjencave Civile në prani të kandidatës për Kryetare Bashkie Majlinda Angoni. Gjithashtu në shkelje të Nenit 6 pika 3 të Vendimit Nr. 9 dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, Z. Haki Cako, gjatë orarit zyrtar të punës, shfaqet pranë kandidatës në zgjedhje në një veprimtari me

karakter publik, aktivitet ky i cili nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ.

- **Drejtues të organeve publike marrin pjesë në një aktivitet politik të pa raportuar**



“Aleksandër Moisiu”, ku u shpall Programi i Specializimit dhe Praktikave Profesionale.

Ky takim vjen në një kohë që përkon me periudhen zgjedhore në referim të Vendimit nr. 2 datë 22.1.2022 i Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi Nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, pasi drejtues të organeve publike apo

enteve te tjera, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia së tyre, marrin pjesë në një veprimtari me karakter politik i cili nuk rezulton të jetë i njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ, sipas parashimeve të nenit 6.

- **Inspektim i investimeve në prezencë të kandidatës për Kryetare Bashkie**



Në prani të kandidatës për Kryetare Bashkie në Lushnjë Eriselda Sefa, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu vizituan ambientet e Spitalit të Lushnjes me rastin investimeve të zhvilluara në atë institucion spitalor, ndërsa Drejtori i Agjencisë Kombëtare së Mbrojtjes Civile, Haki Cako, inspektoi punimet e investimeve mbi Lumin Shkumbim të financuara nga fondi i AKMC, duke promovuar edhe investimet e ardhshme.



Këto aktivitete erdhën në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore në referim të Vendimit nr. 2 pika 2 datë 22.01.2022 i Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi Nenin 91 dhe 92 të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë, pasi drejtues të organeve publike marrin pjesë në një veprimtari të ndaluara, në referim të Nenit 3 pika 1.1/b të Vendimit nr. 9 date 24.12.2020 të Komisionit Rregullator, ku kanë promovuar investimet me interes publik, aktivitete të cilat nuk rezultojnë të jenë njoftuar më parë në ndërfaqen e raportimeve të KQZ.

- **Përdorim i aseteve publike në fushatë zgjedhore**



Në ambientet e jashtme të Shkollës Armathë, kandidatja për kryetare të Bashkisë Durrës, Emiriana Sako, me ka pritur në një takim elektorale banorët e Njesisë Administrative Manëz. Gjatë këtij takimi, sic vërehet nga statusi në profilin personal në Facebook të kandidatës, Znj. Emiriana Sako, por edhe nga mediat, në këtë takim është bërë promovimi i investimeve vendore në atë zonë duke përfshirë procesin e rindërtimit por edhe vetë rikonstruktimin e Shkollës Armathë, ku po zhvillohej takimi në fjalë. Ky aktivitet vjen në një kohë që përkon me fushatën zgjedhore në referim të Vendimit nr. 2 pika 2 datë 22.01.2022 i Komisionit Rregullator, për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, duke shkelur qartazi Nenin

91, pasi nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje burime (aset) të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, gjithashtu edhe në referim të Nenit 3 të Vendimit nr. 9 date 24.12.2020 të Komisionit Rregullator. Oborri, si ambient i jashtëm, gjithashtu është pjesë integrale e institucionit arsimorë në fjalë dhe si i tillë është një aset publik.

- **Njxerrja e akteve ligjore të cilat parashikojnë përfitime monetare**



pune nga njoftimi i saj.


Në datën 04.02.2022, pra vetëm 2 ditë nga data e zgjedhjeve, u zhvilluar mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër ku ndër të tjera referuar rendit të ditës u miratua ndarja e ndihmave financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarret në 2021, rritja e pagave të punonjësve dhe rritja me 6% e ndihma ekonomike për familjet në nevojë. Në vijim në datën 28.02.2022, është njoftuar mbledhja e radhës e Këshillit Bashkiak Shkodër e cila është mbajtur vetëm tre ditë më pas në datën 03.2022, në kundërshtim me rregulloren e kësaj bashkie, konkretisht neni 37, i cili parashikon njoftimin e mbledhjes jo më para se 5 ditë

Nisur nga rrethanat e faktit këto dy mbledhje të mbajtura në kundërshtim me rregulloren e këshillit bashkiak, për sa i përket afateve që kjo e fundit parashikon, në referim edhe të kohës që janë mbajtur e cila përkon me peridhuen zgjedhore, shkojnë gjithashtu në kundërshtim edhe me parashikimet e Kodit Zgjedhor Neni 91 pika 4 dhe Vendimit nr. 9 dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator Neni 3 pika 3.

Kodi Zgjedhor dhe Vendimi Nr. 9 i Komisionit Rregullator, parashikojnë në mënyrë eksplicite ndalimin e propozimit, miratimit ose nxjerrja e akteve ligjore ose nënligjore, të cilat parashikojnë dhënien e përfitimeve për kategori të caktuara të popullsisë, të tilla si aktet që parashikojnë rritjen e pagave, pensioneve, mbështetjes ekonomike apo sociale, uljen ose heqjen e taksave, vendosjen e amnistive fiskale, privatizimin apo dhënien e pasurive a të shpërblimeve.

- **Përdorim i asetëve publike dhe administratës për spot elektoral**

Në spotin elektoral të kandidatës së Partisë Socialiste për Krytare e Bashkisë Shkodër, Znj. Majlinda Angoni, spot i cili është postuar në profilin zyrtar të kandidatës, në datë 02.03.2022, shihet qartë nga imazhet se janë përdorur asetë dhe burime publike.



Konkretisht në sekuençën 00:07, në çelje të spotit, shfaqet mjekja znj. Edona Tafa, e cila hyn në ambientët e Qendrës Shëndetsore "Rrethina", Ambulanca Dobraç dhe në ligjëratën e saj deklaron mbështetjen për kandidatën Znj. Mjalinda Angoni duke shprehur se

"... Jam e bindur që një grua multidimensionale si znj. Majlinda Angoni që e ka sprovuar veten në shumë fush me suksese është zgjedhja e duhur për një bashki të shkodranëve Unë Votoj Mjalinda Angonin. ..."

Pra në këtë rast kemi të bëjmë me mbështetje të kandidatës së PSSH, me burime të organeve publike sic është Qendra Shëndetsore duke shkelur parashikimet e Nenit 91 pika 1 dhe 2 të Kodit Zgjedhor, dhe Vendimin Nr.9 dt. 24.12.2020 të Komisionit Rregullator Neni 3 pika 1.3/c dhe 1.3/ç.

Gjithashtu në referim të Nenit 6 pika 3, "Punonjësit të administratës shtetërore, gjatë orarit zyrtar të punës dhe brenda mjediseve të institucioneve shtetërore, i ndalohet çdolloj pjesëmarrjeje në veprimtari me karakter politik apo në funksion të politikës partiake/kandidatëve apo në fushatë zgjedhore të një subjekti zgjedhor ose kandidati në zgjedhje. Punonjësit të administratës shtetërore i ndalohet të përdorë të mirat publike, funksionin ose veprimtarinë shtetërore ose burimet financiare, materiale, njerëzore publike, me qëllim favorizimin e një partie politike, koalicioni ose kandidati në zgjedhje". Edona Tafa, sic shihet nga pamjet merr pjesë në një veprimtari me karakter politik, sic është spoti elektoral i Znj. Angoni.

4. MONITORIMI I PREMTIMEVE TË KANDIDATËVE

Ekipi i sinjalizuesve të rinj të Qëndresës Qytetare monitoroi premtimet e kandidatëve gjatë dy javëve të fushatës zgjedhore 19 Shkurt – 4 mars 2022. Monitorimi u bazua në aktivitetin e kandidatëve në takime me zgjedhësit, në përballjet me të rinjtë, të organizuara nga Qëndresa Qytetare, daljet mediatike dhe profilet e kandidatëve në rrjetet sociale. Për shkak të kohës së shkurtër që patën në dispozicion për t'u përgatitur dhe kohës së shkurtër që mbart mandati një vjekar i kryetarëve të zgjedhur nga zgjedhjet e 6 marsit, kandidatët erdhën para votuesve pa programe të shkruara dhe detajuara. Premtimet e kandidatëve, kryesisht atyre që fituan garën e 6 marsit ishin të përgjithshme dhe pak të fokusuara në ndërhyrje për zona specifike. Një pjesë e premtimeve nga kandidatët e mazhorancës nuk lidheshin drejtpërdrejt me kompetencat e qeverisje vendore por me premtime të qeverisë qendrore si rasti i ndërtimit të portit në Durrës.

Më poshtë premtimet e 9 kandidatëve për Kryetar Bashkie në bashkitë Durrës, Lushnjë dhe Shkodër:

Bashkia Shkodër

Bardh Spahia

- Investime për parandalimin e përmbytjeve në zonën e Bërdicës.
- Pastrim i kanaleve kulluese dhe përmirësimi i sistemit të trajtimit të mbetjeve.
- Përmirësim i infrastrukturës arsimore
- Mbështetje për trashëgimin, kulturën dhe sportin në nivel vendor
- Braktisja e Velipojës do të marrë fund me 25 Prill, do ti jepet prioritet zhvillimit të biznesit.

Majlinda Angoni

- Përmirësimi i infrastrukturës në shkolla dhe vënia në funksione terreneve sportive
- Do të akordojmë buxhet të posaçëm për rininë, duke mbështetur konkretisht idetë dhe vizionin e tyre
- Një plan konkret për ndërhyrjen në lagjen Kiras, për të përmirësuar jetën e tyre, infrastrukturë e përmirësuar, rrugë të shtruara, ndriçim dhe sistem i ri kanalizimesh.
- Ndërhyrje konkrete në ndihmë të biznesit të vogël dhe të mesëm, për sipërmarrësit në Parrucë dhe Xhabije, rehabilitim i trotuareve, pastrim i qytetit dhe rritje e ofertës turistike të Shkodrës duke mundësuar kështu dhe rritjen e të ardhurave për biznesin lokal.

- Ndërhyrje konkrete për çdo zonë -lagjja Skënderbeg. Mbulimi me shërbim transporti publik, përmirësim i infrastrukturës në shkolla, përfundim i punëve të nisura.

Xhemal Bushati

- Përmirësimi i infrastrukturës, sinjalistikës dhe qarkullimit rrugor në Shkodër.
- Per fermerët do të ofrojmë konculenca dhe përgatitje të dokumentacioneve për skemën e subvencioneve dhe funksionim të sistemeve ujitës në tokat bujqësore.
- Bashki – Universitet do të jetë një binom që pas 6 Marsit do t'i japë Shkodrës produktet më të mira që deri më sot i kanë munguar, duke i rikthyer metropolit verior statusin e vërtetë të një qyteti studentor.
- Kushdo që zgjedh Shkodrën për çeljen e një biznesi të ri, një nga politikat e forta që Bushati si kryebashkiak i ardhshëm premt, është lehtësimi nga taksat. Motoja jonë “biznes i fortë, qytet i fortë”.

Bashkia Lushnjë

Eriselda Sefa

- Modernizimi i hapësirave sportive/ 4 fusha të reja sportive dhe rikonstruksion i stadiumit “Moza Haxhiu”
- Do të realizohet rruga e Gjuzajt, Garunjës por edhe infrastrukturë rrugore në të gjithë fshatrat e tjerë të kësaj njësie dhe më gjerë.
- Agro-pika që do ti vijë në ndihmë fermerit ndërsa siguria e konsumatorit do të jetë në fokus të Bashkisë Lushnje
- Ngritja e një tregu me standarde ashtu sikurse qytetarët e Lushnjës e meritojnë.
- “Përroi i Lushnjës”, “Unaza” e qytetit, markata moderne, investimet ë mëdha në futboll, rruga “Sabri Kosturi” dhe disa rrugë të tjera të brendshme, janë vetëm disa nga projektet e këtij viti.
- Do të vijojmë me punën transformuese në lagjen “Gafurr Muço” në Lushnjë, me disa vepra të rëndësishme infrastrukturore këtë vit!
- Ndërtimi i pritës mbi Lumin Shkumbin, për banorët e fshatit Thanasaj e jo vetëm.
- Një nga projektet më sfiduese do të jetë ngritja e parkut në fushën e plehrave, që ishte një shqetësim i madh prej vitesh për qytetarët e Lushnjes. Gjatë vitit 2022 do të kthehet në një park.

Indrit Sefa

- Plani im i Emergjencës i kushtohet rinisë. Rigjallërimi të jetës kulturore, si dhe një Qendër të Teknologjisë për Rininë. Mbështetja e të rinjve për punësim.
- Bashkia e Lushnjes është një dështim i vërtetë për shkollat. Prapambetja reflektohet tek niveli i ulët i arsimimit, më pak se 10% mbarojnë universitetin, shumë të rinj të tjerë nuk ndjekin as shkollën e mesme.
- Me bindjen se pa arsimim cilësor nuk mund të kemi zhvillim, iu siguroj se infrastruktura në shkolla do të jetë prioritet kryesor në Planin tim të Emergjencës.
- Plani i Emergjencës në kontratën time 1 vjeçare me qytetarët do të përfshijë gjithashtu edhe përmirësimin e infrastrukturës në rrugët e qytetit
- Bujqësia do të jetë në fokus, ku investimet do të jenë të mëdha. Mbështetje për fermerët dhe për infrastrukturën e punës së tyre. Hapje e rrugëve që çojnë parcela, mirëmbajtja e kanaleve kulluese dhe vaditëse, është prioritet i prioriteteve.
- Inspektorët e bashkisë nuk do të mbysin lushnjarët me gjopa as në fshat, as në qytet.

Elton Bano

- Bujqësia është në fokus, ajo do të ketë më shumë subvencione për fermerët e zonës së Lushnjës.
- Blegtorja e cila ka një rënie mbi 50% në 7 vite, do të përpiqemi me doemos që ta ringrejme
- Bashkia do të ketë institucione të veçanta për fermerët dhe konsumatorët
- Do të përmirësojmë infrastrukturën shkollore në çdo shkollë, do të pajisim me ngrohje dhe pajisje të tjera
- Në fshatin Halilaj, njësi administrative Bubullimë do të përmirësojmë ndriçimin, kanalet e papastruara dhe problemet në infrastrukturë.
- Në fshatin Gjazë, njësi administrative Krutje premtoj investime në vende pune të reja, shkolla, kopshte dhe çerdhe për fëmijët, mbi të gjitha zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë.
- Në fshatin Çinar njësinë administrative Fier-Shegan do të marrë fund shqetësimi i banorëve për mungesën e investime
- Në fshatin Krutje e Sipërme në njësinë administrative Krutje do të investohet në infrastrukturë dhe në ndriçimin e rrugëve
- Në lagjen "Skënder Libohova" do të përmirësojmë sistemin e ngrohjes dhe shtimin në ambiente; si ato çlodhëse, apo kërkimore si biblioteka dhe klasa studimi.

Bashkia Durrës

Eriselda Sefa

- Do të ndërtoj shëtitoren më modern të Adriatikut.
- Sukthi do të ketë zyrë të re këshillimi dhe shërbimesh për familjet në nevojë.
- Për banorët e lagjeve 8 & 18, janë një sërë projektesh që do të implementohen, si: Rikonstruksioni i fasadave të pallateve dhe veshja e tyre me kapotë, duke synuar efikasitetin e energjisë.
- Rivitalizimi i kurtalleve midis pallateve, ndriçimi, gjelbërimi dhe ndërtimi i këndeve të lojërave për fëmijë.
- Në lagjen nr. 5 do të investojmë për infrastrukturë të re, parkim e sinjalistikë në shërbim të sipërmarrësve si dhe finalizim të projekteve të rindërtimit.
- Nisma tjetër që kemi marrë është pastrimi në çdo cep të qytetit. Me buxhetin e bashkisë brenda një afati 3-vjeçar do mbjellim 15.000 pemë në qytetin e Durrësit.
- Projekti i Marinës, i cili pritet ta pozicionojë Durrësin në arenën ndërkombëtare, si dhe Hapja e arenës së amfiteatrit.

Ardian Muka

- Do të fokusohemi në gjelbërim, pasi betonizimi është kthyer në kaos.
- Arkitektura e Durrësit duhet të ndryshojë dhe sistemohet.
- Bujqësia dhe fermerët janë lënë në harresë deri tani, po ajo që do bëjmë ne është krijimi i "one stop shop" për ta dhe ndihma me subvencione.
- Bashkia Durrës do të ketë një bashkëpunim shumë të mirë me Universitetin e Durrësit, duke krijuar laboratorë bashkëpunimi për punësimin e të rinjve në ndërmarrjet e Durrësit apo edhe më gjerë.
- Do të ofrohen nga bashkia kurse profesionale për rininë që kjo e fundit të ketë një motiv për të qëndruar dhe të mos braktis në mënyrë masive siç kemi parë, vendin e tyre.
- Krijimi i një parku arkeologjik, ku në zhvillimet e të nesërme, turistët të kenë mundësi ta kalojnë ditën e tyre aty.
- Bashkia do ofrojë mundësinë që turistët të kenë guidë elektronike.

Luan Hoti

- Do të dyfishojmë oraret dhe shpeshtësinë e pastrimit në zonat me sasi më të madhe të prodhimit të plehrave dhe së dyti të menaxhojmë më mirë burimet njerëzore të disponueshme për pastrimin me themel të çdo hapësire të qytetit.

- Brenda 100 ditëve nga marrja e detyrës, Bashkia do të fillojë një konsultim masiv publik me të gjitha kategoritë e bizneseve, duke filluar nga shitësit ambulantë e deri tek bizneset e mëdha me qëllim krijimin e një pakete të re fiskale.
- Urbanizimi përfundimtar i zonës periferike të qytetit, duke përfshirë ish-Kënetën, Spitallën, Shkozetin dhe Unazën e Plazhit është një nga projektet tona kryesore.
- Brenda 100 ditëve të para, bashkia do të vërë në funksion të gjithë mekanizmat ligjorë dhe do të ndërmarrë të gjithë hapat administrativë që të gjithë objektet e banimit në bashkëpronësi të caktojnë administratorë.
Do të përmirësohet menaxhimi i hapësirave për plazhe publike dhe ofrimi i shërbimeve për të gjithë ata qytetarë që do të zgjedhin plazhet publike si alternativë e pushimeve të tyre.
- Do të propozojmë programe mbështetëse për Start Up-et në nivel lokal me një fokus të veçantë në sektorin e turizmit, agroturizmit dhe teknologjive të informacionit.
- Ndërtimi ië Kampusit Universitar dhe të godinave rezidenciale për studentët.
- Do të krijojmë ambiente të dedikuara për moshën e tretë.

5. DITA E ZGJEDHJEVE



Zgjedhjet e 6 marsit mbartën problematikat e zgjedhjeve të zhvilluara në 25 prill sa i përket administrimit. Në përgjithësi procesi i votimit u hap dhe u mbyll në kohën e prashikuar me përjashtim të disa qendrave të votimit, ku për shkak të bllokimit të rrugëve apo mungesës së informacionit mbi përdorimin e pajisjeve elektronike, si në rastin e Vorës.

Votimi familjar u evidentua si problem nga 15 monitoruesit e Qëndresës Qytetare në 6 bashkitë ku u zhvilluan zgjedhjet e pjesshme vendore. Ky fenomen ishte më i theksuar në Bashkinë Vorë ku edhe teknologjia në zgjedhje stimuloi shoqërimin e votuesve të moshuar. Anëtarët e Komisioneve Zgjedhore nuk reagojnë apo mbajtën shënime për këtë fenomen edhe në rastet kur ishte evident.

Prania e personave të paautorizuar në prani dhe brendësi të qendrave të votimit u vu re në qendrat e votimit në Bashkinë e Vorës dhe Durrësit. Shumë përfaqësues të partive, kryesisht të Partisë Socialiste kanë ndihmuar votues të ndryshëm

përveç familjarëve të tyre të moshuar në procesin e votimit. Edhe në oborret e shkollave apo ambienteve të kthyer në qendra votimi pati grumbullime të personave të cilët me gjasë potencialisht mund të kenë ndikuar tek votuesit.

Anetaret e Komisioneve zgjedhore tentuan të komentojnë apo intimidojnë zgjedhësit gjatë procesit të votimit. Kjo u evidentua në disa raste në qendrat e votimit të vendosura në Teatrin Migjeni në Shkodër. Qendra e Votimit me numër 1556, ka pasur mungesa në Komisionin e Zgjedhjeve, konkretisht, mungonte kryetari dhe dy anëtarë të tjerë, përfaqësues të Partisë Demokratike. Në këtë mënyrë kjo qendër votimi u përball me një mungesë veprimi dhe marrje vendimesh në kohë nga ana e komisionit mbi problematika të ndryshme që u paraqitën, si dhjetëra raste të votimit familjar apo ndërhyrje të përfaqësuesve të partive gjatë procesit zgjedhor të zgjedhësve.

Teknologjia në zgjedhje e cila u përdor në Bashkinë Vorë sa i përket votimit dhe në 6 bashkitë e tjera sa i përket identifikimit shfaqti disa problematika lidhur me pajisjet dhe administrimin e procesit. Dëmtimi i pajisjeve të identifikimit elektronik shkaktoi bllokime të procesit të votimit në shkollën "Leonik Tomeo".

Mungesa e njohurive për përdorimin e pajisjes elektronike dhe vështirësitë e shfaqura nga qytetarët gjatë procesit të votimit kanë qenë të shumta, duke sjellë kështu një numër të pafundëm votimesh familjare, por edhe ndikime nga përfaqësues të partive politike prezentë në qendrat e votimit. Vetëm në qendrat e votimit me numër 1557 dhe në atë 1557/01 në bashkin Vorë, operatorët teknikë (përgjegjës për funksionimin e pajisjeve elektronike të votimit) kanë qenë personat të cilët u kanë ardhur në ndihmë votuesve gjatë përdorimit të pajisjes në procesin e votimit, por duke mbajtur distancën dhe respektuar të drejtën e mos-ndikimit në vendimin e zgjedhësit.

6. Rekomandime

- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** duhet të ngrëjë një task forcë ad - hoc për administrimin dhe ndjekjen e kallzimeve për burimet shtetërore përgjatë fushatës zgjedhore për të demotivuar zyrtarët publikë që tentojnë të shkelin kodin zgjedhor.
- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** duhet të përshpejtojë shqyrtimin me rigorozitet të të gjitha kallzimeve të ardhura nga partitë politike dhe shoqëria civile për përdorimin e burimeve shtetërore në fushatë zgjedhore dhe të kallzojë krejsisht në prokurori rastet kur shkeljet përbëjnë edhe vepër penale.
- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** duhet të nxjerrë një manual për orientimin e aktorëve të shoqërisë civile dhe qytetarëve lidhur me kallzimet për përdorimin e burimeve shtetërore dhe raportimin e aktiviteteve të institucioneve publike.
- **Komisioni Qendror i Zgjedhjeve** duhet të nxjerrë një udhëzim për formën e raportimit të aktiviteteve të institucioneve shtetërore dhe të vendosë në veprim autoritetin e tij për të parandaluar aktivitetet e ndaluara duke i shpallur paraprakisht në ndërfaqen e tij si të tilla.
- **Komisioni Parlamentar për Reformën Zgjedhore** duhet të rishikojë sanksionet administrative për zyrtarët që vihen në dispozicion të fushatës zgjedhore duke rritur masën e dënimeve me gjobë.
- **Komisioni Parlamentar për Reformën Zgjedhore** duhet të parashikojë normative dhe sanksione ligjore për parandalimin e përfshirjes sistematike të minsitrave dhe zyrtarëve të lartë në fushatë zgjedhore duke lënë pas dore detyrat e tyre shtetërore.
- **Institucionet shtetërore** në nivel vendor dhe qendror duhet të zbatojnë me rigorozitet vendimin nr.9 të Komisionit Rregullator sa i përket raportimit të veprimtarive më karakter publik.
- **Organizatat që kanë në fokus zgjedhjet dhe media** duhet të luajnë një rol më aktiv në monitorimin e zbatimit të kodit zgjedhor, përdorimin e burimeve shtetërore në fushata dhe kallëzimin e rasteve specifike duke siguruar një garë të barabartë dhe të drejtë mes palëve politike.



Qëndresa
Qytetare



Funded by
UK Government